



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "ALEN Construction" Sh.P.K. të datës 29.04.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i objekteve komunale dhe bashkësive lokale" me nr. të prokurimit 616-26-2203-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "ALEN Construction" Sh.P.K. të datës 29.04.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i objekteve komunale dhe bashkësive lokale" me nr. të prokurimit 616-26-2203-5-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "ALEN Construction" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 21.04.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i objekteve komunale dhe bashkësive lokale" me nr. të prokurimit 616-26-2203-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: *“f) Inxhinier I diplomuar me përvojë pune min 8 vite pas diplomimit. – menaxher I projektit i qertifikuar per siguri dhe shendet ne pune nga nje kompani e licencuar nga MPMS poashtu te jete I certifikuar nga Ministria e Mbrendshme , agjencia e menaxhimit emergjent”*.

Në kërkesën e lartcekur nuk është specifikuar se çfarë profili të inxhinierit kërkohet dhe nga cili drejtim duhet të jetë i diplomuar, gjë që lë hapësirë për interpretime të ndryshme nga ana e operatorëve ekonomik. Po ashtu, pjesa e certifikimeve është e paqartë, pasi që në kërkesë përmenden Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencia e Menaxhimit Emergjent pa sqaruar llojin e certifikimit që kërkohet. Duke qenë se ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me renovimin e objekteve komunale dhe bashkësive lokale, kjo kërkesë nuk është relevante për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Andaj kur kemi parasysh faktet e lartcekura, kërkojmë që kërkesa e lartcekur të largohet në tërësi nga dosja e tenderit, me qëllim të hapjes së konkurrencës dhe të mos konfuzohen OE e interesuar për ofertim, me kërkesa të paqarta.

Tek kapaciteti teknik dhe profesional po ashtu është kërkuar: *“d) Inxhinier i Diplomuar i Arkitektures ose master përvojë pune min 8 vite pas diplomimit i njejta duhet te jete I trajnuar për rreth organizimit menaxhimit dhe sigurisë në kantiere të ndërtimit”*.

Kërkojmë që të ndryshohet kërkesa e lartcekur përkatësisht të largohet pjesa ku specifikohet *“duhet të jetë i trajnuar për rreth organizimit menaxhimit dhe sigurisë në kantiere të ndërtimit”*, pasi e njëjta është kriter i panevojshëm dhe jo proporcional me objektin e kontratës, duke qenë se tenderi ka të bëjë me renovimin e objekteve komunale dhe bashkësive lokale, e jo me projekte të natyrës së rëndë ndërtimore apo infrastrukture. Kërkesa për Inxhinier të Diplomuar të Arkitekturës ose Master me përvojë pune minimale 8 vite pas diplomimit është e mjaftueshme për të dëshmuar kapacitetin profesional dhe teknik të stafit të kërkuar. Vendosija e trajnimeve shtesë të paarsyetuara kufizon konkurrencën dhe bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe

trajtimin të barabartë të operatorëve ekonomikë. Prandaj kërkojmë që të bëhet ndryshimi i kërkesës së lartcekur, sipas pretendimit tonë ankimor.

Tek kapaciteti teknik dhe profesional po ashtu është kërkuar: *"g) Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë drejtimi hidroteknike me përvojë pune min 5 vite pas diplomimit I njejtë duhet te jete trajnuar per sistemet e ngrohjes dhe ftohjes duke përfshirë teknologjine e kontrollit"*.

Kërkojmë që të ndryshohet kërkesa e lartcekur, duke u larguar pjesa e kriterit *"i njëjti duhet të jetë i trajnuar për sistemet e ngrohjes dhe ftohjes duke përfshirë teknologjinë e kontrollit"*, pasi kjo kërkesë nuk është në përputhje me profilin profesional të Inxhinierit të Diplomuar të Ndërtimtarisë – drejtimi Hidroteknik. Fusha e sistemeve të ngrohjes, ftohjes dhe teknologjisë së kontrollit i përket drejtpërdrejt inxhinierisë mekanike, respektivisht drejtimin termoenergjetik, profil i cili veçse është kërkuar tek pika c) e kapacitetit teknike dhe profesional në dosjen e tenderit ku është kërkuar një Inxhinier të Diplomuar apo Bachelor të Inxhinierisë Mekanike – drejtimi termoenergjetik me tri vite përvojë pune pas diplomimit. Vendosja e së njëjtës kërkesë edhe për profilin hidroteknik paraqet dublifim të panevojshëm të kërkesave të dosjes së tenderit, sepse kërkesa e specifikuar nga AK-ja nuk lidhet me kompetencat bazë të atij profili dhe kufizon pa nevojë konkurrencën.

Andaj, kur kemi parasysh të lartcekura, kërkojmë që të bëhet ndryshimi i kërkesës së lartcekur, sipas pretendimit tonë.

Në dosje të tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar *"h) Inxhinier i Diplomuar ose Baqelor ne Inxhinieri Softuerike IT me përvojë pune min 3 vite pas diplomimit i njejtë duhet te jete i qertifikuar ne Cisco Certified Netëork Associate (CCNA)"*.

Kërkojmë që të largohet në tërësi nga dosja e tenderit kërkesa e lartcekur, pasi që e njëjta nuk është relevante fare me objektin e kontratës dhe natyrën e aktivitetit të prokurimit, i cili aktivitet ka të bëjë me renovimin e objekteve komunale dhe bashkësive lokale. Kërkesa për profil të inxhinierisë softuerike/IT si dhe certifikim specifik në rrjete kompjuterike CCNA lidhet me administrim rrjetesh, konfigurim pajisjesh dhe infrastrukturë IT, mirëpo në asnjë mënyrë nuk ka të bëjë me punime ndërtimore, renovuese apo mirëmbajtëse të objekteve. Vendosja e një kriteri të tillë është joproportionale, i panevojshëm dhe kufizon konkurrencën në maksimum. Andaj, kërkojmë që kërkesa e lartcekur të largohet në tërësi nga Dosja e Tenderit, me qëllim të hapjes së konkurrencës.

Tek kapaciteti teknik dhe profesional pika i), është kërkuar *"i) Nje punetor Teknik i diplomuar te Elektroteknikes min 10 vite pas diplomimit i njejtë duhet te jete i qertifikuar me qertifikate te ndihmes se pare , si dhe qertifikate per siguri dhe shendet ne pune nga nje kompani e licencuar nga MPMS"*.

Kërkojmë që të largohet në tërësi kërkesa e lartcekur nga DT, pasi që e njëjta është e panevojshme, jo proporcionale dhe e dyfishuar, kur kemi parasysh faktin se në dosje të tenderit është kërkuar tek pika b) *"një inxhinier të diplomuar apo Bachelor të elektroteknikës – drejtimi energjetik me tri vite përvojë pune pas diplomimit"*. Duke marrë parasysh faktin se inxhinieri i elektroteknikës tashmë mbulon aspektet teknike të fushës, vendosja e një kërkesë shtesë "punëtor teknik i diplomuar" me kërkesa të ekzagjeruara për përvojë 10 vjeçare dhe certifikime specifike të ndihmës së parë dhe sigurisë në punë paraqet dublifim të panevojshëm të kërkesave dhe nuk përkon fare me natyrën e

kontratës që ka të bëjë me renovimin e objekteve komunale dhe bashkësive lokale. Për më tepër, çështjet e sigurisë në punë dhe ndihmës së parë janë obligime të përgjithshme ligjore të operatorit ekonomik dhe stafit në kantier, prandaj nuk mund dhe nuk duhet të imponohen si kriter i veçantë për një pozitë specifike, pasi kjo kufizon konkurrencën dhe nuk ndikon drejtpërdrejt në ekzekutimin e kontratës.

Andaj, kërkojmë që ky kriter të largohet në tërësi nga dosja e tenderit.

Në dosje të tenderit, tek kapaciteti teknik dhe profesional po ashtu janë specifikuar kërkesat si në vijim:

Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj Autorizimin nga prodhuesi ose furnitori për pozicionet (1.5, 1.6, 2.15, 2.16, 3.47, 3.20, 4.5, 4.6, 4.10, 5.1, 5.2, 6.1, 7.19, 9.1, 9.2, 9.6, 9.8, 9.10, 9.17, 10.12, 10.16, 13.1, 13.2, 13.3, 13.8, 13.19, 15.33, 15.42, 15.43, 15.44, 15.45, 15.46, 15.47, 15.48, 15.49, 17.8, 17.9); Dëshmia e kërkuar: Dëshmia 3. Autorizimin nga prodhuesi ose furnitori.

Kërkesa 4. Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj katalogun nga prodhuesi me specifika për pozicionet e paramasës sic janë të përshkruara (1.5, 1.6, 2.15, 2.16, 3.47, 3.20, 4.5, 4.6, 4.10, 5.1, 5.2, 6.1, 7.19, 9.1, 9.2, 9.6, 9.8, 9.10, 9.17, 10.12, 10.16, 13.1, 13.2, 13.3, 13.8, 13.19, 15.33, 15.42, 15.43, 15.44, 15.45, 15.46, 15.47, 15.48, 15.49, 17.8, 17.9); Dëshmia e kërkuar: Dëshmia 4. Katalog nga prodhuesi me specifika për pozicionet e përshkruara.

Kërkesa 5. Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj garancion - minimum 2 vite nga prodhuesi për pozicionet e specifikuar në paramasë; Dëshmia e kërkuar: Dëshmia 5. Garancion nga prodhuesi me specifika për pozicionet e përshkruara.

Kur kemi parasysh faktin se ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me renovimin e objekteve komunale dhe bashkësive lokale, atëherë konsiderojmë se kërkesat për dorëzimin e autorizimit nga prodhuesi, katalogut teknik dhe garancisë nga prodhuesi për pozicionet e paramasës janë të panevojshme dhe jo proporcionale me natyrën e kontratës.

Shumica e produkteve të përcaktuara në pozicionet e kërkuara nga ana e AK-së janë materiale dhe pajisje standarde ndërtimore, të cilat janë në sasi të mëdha të disponueshme në treg dhe të njëjtat mund të furnizohen nga një numër i madh operatorësh ekonomikë pa pasur nevojë për autorizime direkte nga prodhuesit.

Kërkesa për këto dokumente në fazën e ofertimit krijon barrë të panevojshme administrative dhe kufizon konkurrencën, duke favorizuar operatorë të caktuar të cilët posedojnë autorizimet nga prodhuesi për pozicionet e përcaktuara nga ana e AK-së dhe duke përjashtuar operatorë të tjerë me përvojë të madhe në këtë fushë që mund të përmbushin plotësisht specifikat teknike përmes furnizimit të rregullt në treg.

Për më tepër, këto dokumente nuk janë të domosdoshme për vlerësimin e ofertave, pasi që përmbushja e specifikave teknike mund të sigurohet përmes një deklaratë nga operatori ekonomik. Një deklaratë që OE do të përmbahet në tërësi specifikimeve teknike dhe materialet e kërkuara do të jenë në përputhje me kërkesat e AK-së, do të ishte e mjaftueshme në këtë fazë.

Prandaj kur kemi parasysh faktet e lartcekura, kërkojmë që kërkesat e lartcekura të largohen në tërësi nga dosja e tenderit, me qëllim të sigurimit të një procesi të hapur, konkurrues dhe në përputhje me parimet e prokurimit publik.

Gjithashtu kur kemi parasysh faktin se sasia e kërkuara për të gjitha pozicionet është specifikuar "1.00", kërkojmë që të na sqarohet se në këtë tender a është kriteri Tenderi i

përgjegjshëm me çmimin më të ulët apo Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e lartcekura kuptohet qartë se dosja e tenderit nuk është përgatitur në harmoni me legjislacionin në fuqi, pasi që janë vendosur kërkesa diskriminuese të cilat ju pamundësojnë ofertimin kompanive të interesuar në këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht favorizojnë kompani të caktuara.

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*.

Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur.

Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”*.

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton se ju si autoritet kontraktues nuk e keni përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e keni pasur parasysh as nenin 17.7 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që *“Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve”*.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj kërkesat të cilat i kontestuar më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, sepse aty shkruan qartë se *“Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do të kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE*


Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur se kërkesat për stafin profesional por edhe autorizimet e prodhuesit, katalogu, garancioni janë absolutisht të domosdoshëm për të garantuar realizimin e projektit në mënyrë efikase dhe efektive. Duhet sqaruar se kërkesat e DT janë vendosur në përputhje të plotë me qëllimin dhe specifikat e aktivitetit të prokurimit. Sipas nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 04.05.2026

Wisar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.